



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 81 prot.

Kamëz, më 17.06.2022

V E N D I M
Nr. 68 .Datë 17 / 06 2022
M B I

“MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET BASHKISË KAMËZ DHE WORLD VISION PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT: “KRIJIMI I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE SPORTIVE” PRANË SHKOLLËS “HALIT ÇOKA”.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.06.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.65 Datë 16.06.2022 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.8788/2001 “Për organizatat jo fitimprurëse” (i ndryshuar), Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I :

1. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe World Vision për zbatimin e projektit: “Krijimi i qendrës multifunksionale sportive” pranë shkollës “Halit Coka”.
2. Miratimin e buxhetit prej 7.713.775 (shtatë milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë) lek. Bashkia Kamëz do të financojë përkatësisht 3.856.887.5 (tre milion e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë pesë) lek dhe Ëord Vision do të financojë 3.856.887.5 (tre milion e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë pesë) lek.
3. Struktura buxhetore Gr. 0 Prog. 09120 Kap.5 Art.231
4. Ky fond është miratuar në buxhetin e bashkisë me VKB nr. 42 datë 29.03.2022 “Për një ndryshim në VKB nr.132 datë 22.12.2021 “Për miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2022, 2023, 2024.”
5. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit dhe Drejtoria e Integritimit në BE dhe Projekteve të Huaja.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Kryetar Këshilli
Hysen KOLDASHI